



Termt e references

Emri dhe Adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri : UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NË RAJON

Adresa : Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati 2, Zyra 18, Tiranë;

E-mail : ubshr@tirana.al

Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon (me poshte Unioni) është një bashkim vullnetar, i lirë dhe i pavarur i Komunave të: Prishtinës, Preshevës, Prizrenit, Tetovës, Çairit, Gostivarit, Ulqinit, Tuzit dhe Bashkisë së Tiranës. Ajo është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, joqeveritare e formës Shoqatë.

Shoqata me emrin UBShR është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 29.07.2019 me Nr. vendimi 6305. Regjistrim i saj është në përputhje me Ligjin Nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” dhe sipas Ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” me nr NIPT L92006451C.

Qëllimet kryesore të UBShR janë:

- Të krijoje një platformë bashkëpunimi që do t’u lejojë bashkive/komuna anëtare të intensifikojnë shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës në fushat e urbanistikës, inovacionit, mjedisit, kulturës dhe formave të reja të financimit;
- Të ngreje një Grup të Përhershëm Koordinator që ka për detyrë të ndërmjetësojë në mënyrë të pandërprerë komunikimin dhe bashkëpunimin konkret mes bashkive/komuna anëtare për të gjitha fushat me interes;
- Të zhvilloje shkëmbime të rregullta ekspertize, përvoja dhe projektsh që kanë rezultuar të suksesshme;
- Të krijojë rretëzimin e bizneseve në rajonin shqipfolës.
- Të zhvilloje rregullisht programe të përbashkëta kulturore e artistike;
- Të punoje për thithjen e fondeve dhe projekteve rajonale dhe ndërkufitare;

Përmes një aplikimi të suksesshëm në Ambasadën Amerikane në Shqipëri, në fondin e Small Grants for Democracy, UBShR do të implementojë projektin WORD (WOMEN ON RURAL DEVELOPMENT).

Projekti WORD (Gratë në Zhvillim Rural) do të kontribuojë në fuqizimin e 100 grave në gjashtë njësi administrative të Tiranës, përmes njohurive në zinxhirin agroturistik, duke përmirësuar situatën e tyre ekonomike dhe duke siguruar ndërtimin e kapaciteteve.

UBSHR, në kuader të realizimit të projektit, ka parashikuar realizimin e dy spoteve promovues i te cilët do të njohin dhe informojnë publikun me këtë projekt, njësitë administrative që do të përfshihen, fokusin dhe objektivat e tij. Për këtë arsye, hapet thirrja për angazhimin e një subjekti për zhvillimin e dy spoteve të shkurtër promovues (produksion dhe post produksion) me specifikat si më poshtë:

1. Paraqitja e dokumentacionit

Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë:

- Një përshkrim të shkurtër të subjektit që kryen shërbimin (CV profesionale)
- Stafin e vendosur në dispozicion
- Buxhetin, duke përfshirë të gjitha shpenzimet (gjithashtu TVSH). Aspekti financiar duhet të tregojë totalin e shumës, duke marrë parasysh të gjitha shpenzimet përkatëse të nevojshme për realizimin e shërbimit të kërkuar.
- Ekstraktin e QKB

2. Specifikat e shërbimeve të kërkuara janë si më poshtë:

Para-Produksion

- Përgatitja e një koncepti, ideje për zhvillimin e spotit

Produksioni

- Angazhimi i ekipit që nevojitet për të realizuar spotin
- Pajisjet teknike të nevojshme
- Sigurimi xhirimeve arial/dron
- Sigurimi transportit të stafit

Post-Produksion

- Redaktimi i videos rreth 60-90 sekonda
- Montazh
- Korrigjimi i ngjyrave
- Audio Mix
- Titrat
- Grafika
- Muzikë e Licensuar

3. Pagesa

Fondi limit i parashikuar është në vlerë totale të kontratës prej \$4,000 (ku përfshihen gjithë detyrimet financiare) për produksionin dhe post produksionin, der në përfundim të dy spoteve.

Në këtë vlerë përfshihet puna përgatitore para realizimit të spotit, filmimet, vendosja në dispozicion e stafit të duhur dhe përgatitja brenda afateve kohore të montazhit të spotive, sipas kërkesave të UBSHR-së. Të gjitha kostot e tjera të përgatitjes së spoteve, janë detyrim i subjektit.

4. Vendi i zhvillimit të filmimeve

Vendi i zhvillimit të filmimeve është në 6 njësi administrative të Tiranës.

5. Kohëzgjatja e kontratës

Detyrimet hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës dhe kontrata përfundon në datën e kryerjes së detyrimit të fundit ndaj të kontraktuarve. Kontrata nuk është e rinovueshme pas përfundimit të projektit WORD.